



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

PASQYRAT FINANCIARE TË BQK-së
/për tremujorin e parë 2017/
-Raport i ndërmjetëm i pa audituar-

Departamenti për Planifikim dhe Raportim Financiar

Pasqyrat financiar te BQK-së për tremujorin e parë 2017

E përcaktuar me Ligjin 03/L-209“Mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” (me iniciale BQK),si kornizë raportuese për përgatitjen e pasqyrave financiare janë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, përkatësisht nenit 58 të ligjit të përmendur me lartë. Këto pasqyra për tremujorin e parë përfshijnë *pasqyrën e gjendjes financiare dhe llogarinë e përmbledhur të të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe rezerva (ekuitet)*. Viti financiar i BQK-së përputhet me vitin kalendarik, si rrjedhojë, data e raportit për pasqyrat financiare të tremujorit të parë është 31 mars 2017.

Shkurtesa te përdorura ne raport:

BQK – Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

FMN – Fondi Monetar Ndërkombëtar

DST (SDR) – Te Drejtat Speciale te Tërheqjes

TI – Teknologjia Informative

SNP – Sistemi ndërbankar i pagesave

BQE (ECB) – Banka qendrore europiane

Pasqyra e gjendjes financiare

sipas të dhënave me


	Shënim	31 Mars 2017	31 Dhjetor 2016
Mjetet			
Paraja e gatshme	5	210,082,152.81	154,800,143.92
Llogarit rrjedhëse me bankat e huaja	6	212,635,429.95	207,742,023.04
Letrat me vlerë	7	588,499,493.87	572,375,111.49
Plasmanët në tregun e parasë	8	215,026,254.16	195,049,006.93
Mjetet e ndërlidhura me FMN	9	361,002,335.12	275,560,613.30
Prona dhe pajisjet	10	4,597,001.65	4,483,418.51
Mjetet e paprekshme	11	2,195,200.15	2,271,391.31
Mjete tjera	12	1,342,281.31	1,283,839.84
Gjithsej mjetet		1,595,380,149.02	1,413,565,548.34
Detyrimet			
Ndaj bankave komerciale në vend	13	302,281,783.50	296,398,919.68
Ndaj llogarive të lidhura me FMN	14	369,088,223.21	283,009,428.41
Ndaj institucioneve qeveritare	15	814,144,268.79	718,434,919.83
Ndaj institucioneve publike dhe komerciale	16	52,945,361.28	58,867,305.74
Nga huamarrja/et	17	2,266,259.07	2,133,133.87
Detyrime tjera vendore	18	1,721,292.68	2,039,252.12
Gjithsej detyrimet		1,542,447,188.53	1,360,882,959.65
Kapitali dhe rezervat			
Kapitali i autorizuar	19	30,000,000.00	30,000,000.00
Fondi rezervë	20	22,682,588.69	21,022,583.81
Neto rezultati i periudhës		250,371.80	1,660,004.88
Gjithsej kapitali dhe rezervat		52,932,960.49	52,682,588.69
Gjithsej detyrimet, kapitali dhe rezervat		1,595,380,149.02	1,413,565,548.34

Shënimet prej faqes 6 deri 17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare të shpalosura më poshtë janë aprovuar nga menaxhmenti me datë 27 Maj 2017 dhe janë nënshkruar në emër të tyre nga:



Bedri Hamza
Guvernator



Faton Ahmetaj
Drejtor për planifikim dhe
raportim financiar

Pasqyra e përmbledhur e të ardhurave

	Shënim	31 Mars 2017	31 Mars 2016
Te hyrat nga interesi (kamata)			
Të hyrat nga interesi		447,618.47	397,487.08
Shpenzimet nga interesi		(135,265.34)	(10,568.00)
Neto të hyrat nga interesi	21	312,353.13	386,919.08
Te hyrat nga tarifat dhe ndalesat			
Të hyrat nga tarifat dhe ndalesat		454,566.49	427,606.03
Shpenzimet nga tarifat dhe ndalesat		(38,802.91)	(96,686.40)
Neto të hyrat nga tarifat dhe ndalesat	22	415,763.58	330,919.63
Te hyrat nga aktiviteti rregullator dhe t 'hyra tjera operative			
Të hyrat nga aktiviteti rregullator	23	932,400.00	849,050.00
Të hyrat nga grantet	24	25,428.47	16,654.83
Të hyrat tjera operative	25	-	1,969.40
Të ardhurat operative		1,685,945.18	1,585,512.94
Shpenzimet administrative (operative)			
Shpenzimet për personelin	26	(1,018,552.40)	(893,024.10)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	10,11	(240,960.84)	(157,409.18)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	27	(228,360.81)	(212,026.30)
Shpenzimet administrative (operative)		(1,487,874.05)	(1,262,459.58)
Neto rezultati pa efektin e kursit të këmbimit		198,071.13	323,053.36
Neto fitimi/humbja nga kursi i këmbimit valutor	28	52,300.67	984,790.36
Neto rezultati i periudhës		250,371.80	1,307,843.72

Shënimet prej faqes 6 deri 17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet (kapital dhe rezerva)

	Kapitali i Autorizuar	Fond i rezervave	Neto rezultati i periudhës	Gjithsej
<i>Saldo me 01 Janar 2016</i>	30,000,000.00	20,334,791.90	687,791.91	51,022,583.81
<i>Rezultati financiar i periudhës</i>	-	-	1,660,004.88	1,660,004.88
<i>Transferi në fondin rezervë</i>	-	687,791.91	(687,791.91)	-
<i>Transferi në kapital të autorizuar</i>	-	-	-	-
<i>Saldo me 31 Dhjetor 2016</i>	30,000,000.00	21,022,583.81	1,660,004.88	51,022,583.81
<i>Saldo me 01 Janar 2017</i>	30,000,000.00	21,022,583.81	1,660,004.88	51,022,583.81
<i>Rezultati financiar i periudhës</i>	-	-	250,371.80	250,371.80
<i>Transferi në fondin rezervë</i>	-	1,660,004.88	(1,660,004.88)	-
<i>Transferi në kapital të autorizuar</i>	-	-	-	-
<i>Saldo me 31 Mars 2017</i>	30,000,000.00	22,682,588.69	250,371.80	52,932,960.49

Shënimet prej faqes 6 deri 18 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

1. Institucioni Raportues

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës - BQK, e cila operon sipas Ligjit nr. 03/L-209“Mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” të aprovuar në Korrik të vitit 2010.

2. Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare

Korniza Raportuese

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë të përgatitura në bazë të kostos historike dhe të harmonizuara sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Valuta e funksionale dhe e prezantuar

Këto pasqyra financiare janë të prezantuara në EURO, qe është valutë zyrtare funksionale e Kosovës. Në rast se vlerat janë të shprehura në valuta tjera atëherë do të këtë shënim përkatës aty ku janë të paraqitura ato.

3. Politikat kontabël

Pasqyrat financiare janë të përgatitura duke shfrytëzuar konsistencën e politikave kontabël, dhe duhet theksuar se nuk ka pasur ndonjë politikë të re ose ndryshim në politikat e aplikuara kontabël.

4. Menaxhimi i rrezikut financiar

Rreziku financiar në BQK është i paraqitur në formën e : rrezikut të likuiditetit, rrezikut operacional, rrezikut kreditor dhe rrezikut të tregut. Rreziku financiar në BQK ndërlihet më së shumti me punët e menaxhimit të mjeteve dhe kryesisht menaxhohet nga Departamenti i Menaxhimit të Mjeteve në përputhje me politikën e menaxhimit të mjeteve të aprovuar nga Bordi i BQK-së. Mjetet e ekspozuara nga aktiviteti i menaxhimit financiar të tyre janë kryesisht në shtete të Bashkimit Evropian me vlerësim kreditor shumë të mirë (prej A-1 deri A-3/ P-1 deri P-2).

Menaxhimi i Rrezikut të Likuiditetit (vazhdim)

Vlerat bartëse sipas maturitetit të mbetur

	Shënim	Shuma e bartur	më pak se 3 muaj	3-6 muaj	6 muaj - 1 vit	1 - 5 vite	mbi 5 vite
30 Shtator 2017							
Mjetet							
Paratë e gatshme	5	210,082,152.81	210,082,152.81	-	-	-	-
Llogaritë rrjedhëse në bankat Jo-rezidente	6	212,635,429.95	212,635,429.95	-	-	-	-
Letra me vlerë	7	588,499,493.87	85,118,451.15	12,538,298.35	124,398,606.85	366,444,137.51	-
Llogaritë depozituese me bankat jorezidente	8	215,026,254.16	25,006,095.83	80,014,175.00	110,005,983.32	-	-
Mjetet e ndërlidhura me FMN	9	361,002,335.12	211,999,585.12	9,245,625.00	4,357,125.00	135,400,000	-
		1,587,245,665.91	744,841,714.87	101,798,098.35	238,761,715.17	501,844,137.51	-
Detyrimet							
Ndaj bankave vendore	13	(302,281,783.50)	(302,281,783.50)	-	-	-	-
Ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	14	(369,088,223.21)	(220,085,473.21)	(9,245,625.00)	(4,357,125.00)	(135,400,000.00)	-
Ndaj institucioneve qeveritare vendore	15	(814,144,268.79)	(814,144,268.79)	-	-	-	-
Ndaj entiteteve publike dhe tregtare	16	(52,945,361.28)	(52,945,361.28)	-	-	-	-
Nga huamarrja / et	17	(2,266,259.07)	-	-	-	(339,938.86)	(1,926,320.21)
Detyrime tjera vendore	18	(1,721,292.68)	(1,721,292.68)	-	-	-	-
		(1,542,447,188.53)	(1,391,178,179.46)	(9,245,625.00)	(4,357,125.00)	(135,739,938.86)	(1,926,320.21)
		44,798,477.38	(646,336,464.59)	92,552,473.35	234,404,590.17	366,104,198.65	(1,926,320.21)
31 Dhjetor 2016							
Mjetet							
Paratë e gatshme	5	154,800,143.92	154,800,143.92	-	-	-	-
Llogaritë rrjedhëse në bankat Jo-rezidente	6	207,742,023.04	207,742,023.04	-	-	-	-
Letra me vlerë	7	572,375,111.49	10,537,912.38	76,048,911.69	20,463,211.00	465,325,076.43	-
Llogaritë depozituese me bankat jorezidente	8	195,049,006.93	40,034,555.56	25,004,220.83	130,010,230.55	-	-
Mjetet e ndërlidhura me FMN	9	275,560,613.30	195,980,863.30	9,777,000.00	13,602,750.00	56,200,000.00	-
		1,405,526,898.68	609,095,498.19	110,830,132.53	164,076,191.54	521,525,076.42	-
Detyrimet							
Ndaj bankave vendore	13	(296,398,919.68)	(296,398,919.68)	-	-	-	-
Ndaj llogarive të lidhura me FMN	14	(275,560,613.30)	(195,980,863.30)	(9,777,000.00)	(13,602,750.00)	(56,200,000.00)	-
Ndaj institucioneve qeveritare vendore	15	(718,434,919.83)	(718,434,919.83)	-	-	-	-
Ndaj entiteteve publike dhe tregtare	16	(58,867,305.74)	(58,867,305.74)	-	-	-	-
Nga huamarrja / et	17	(2,133,133.87)	-	-	-	(319,970.08)	(1,813,163.79)
Detyrime tjera vendore	18	(2,039,252.12)	(2,039,252.12)	-	-	-	-
		(1,353,434,144.54)	(1,271,721,260.67)	(9,777,000.00)	(13,602,750.00)	(56,519,970.08)	(1,813,163.79)
		52,092,754.14	(662,625,762.48)	101,053,132.53	150,473,441.54	465,005,106.34	(1,813,163.79)

5. Paraja e gatshme

	31 Mars 2017	31 Dhjetor 2016
Paraja e gatshme	210,082,152.81	154,800,143.92
Gjithsej	210,082,152.81	154,800,143.92

Vërehet rritje e saldosh me 31 mars 2017 krahasuar me 31 dhjetor 2016. Kjo rrjedh nga pamundësia e plasimit (afatizimit) të mjeteve në tregjet financiare si rrjedhojë e normave shumë të ulëta dhe negative. Kështu është vendosur që të mbahen më shumë mjete si para të gatshme për të ju ikur normave negative që bankat korrespondente na ngarkojnë mbi limite të caktuara.

6. Llogaritë rrjedhëse me bankat jo vendore

Përbërja e llogarive rrjedhëse me banka jo vendore është si më poshtë:

	31 Mars 2017	31 Dhjetor 2016
Deutsche Bundesbank	83.70	10.73
Raiffeisen Zentralbank	29,499,996.63	29,420,956.42
Deutsche Bank London AG	98,576,222.34	97,408,364.91
Nostro Acc. Commerzbank AG	83,559,152.78	79,912,698.48
Nostro Acc. Bayerische Landesbank	999,974.50	999,992.50
Gjithsej	212,635,429.95 €	207,742,023.04

Pozicioni i llogarive rrjedhëse krahasuar me 31 dhjetor 2016 nuk ka ndryshuar shumë, dhe ndryshimi është rrjedhe normale e aktivitetit të këtyre llogarive dhe të menaxhimit të portofolios së mjeteve (përkatësisht shënimeve 6, 7 dhe 8 që janë shumë ngushtë të lidhura njëra me tjetrën referuar nga aspekti i menaxhimit të mjeteve).

7. Letrat me Vlerë (Bono thesari dhe Obligacione qeveritare)

Të dy kategoritë që bëjnë pjesë në kuadër të grupimit me shënim 7 janë letra të borxhit qeveritare të lëshuara nga vendet sipas listimit me poshtë (ne tabelën sipas shteteve). Bonot e thesarit të shpalosura më poshtë kanë maturitet deri në një vit. Ndërsa ato të obligacioneve qeveritare kanë maturitet deri në katër vite. Të gjitha janë në Euro dhe kanë norma të interesit efektiv që lëvizin nga 0.008% deri 2.696% vjetore në vitin 2017 (në vitin 2016: 0.008% deri në 2.696% vjetore).

Letra me vlerë (vazhdim)**Sipas shteteve:**

	31 Mars 2017	31 Dhjetor 2016
Holandë	50,249,679.39	50,247,618.30
Itali	365,367,718.83	368,853,287.55
Sllovenia	23,112,752.27	23,541,537.04
Kosovë	149,769,344.21	129,732,669.69
Gjithsej	588,499,494.87	572,375,112.57

Letra me vlerë (vazhdim)**Sipas llojit:**

	31 Mars 2017	31 Dhjetor 2016
Bono Thesari	45,360,538.58	40,452,267.84
Obligacione qeveritare	543,138,955.29	531,922,844.73
Gjithsej	588,499,493.87	572,375,112.57

Të ky grupim vërehet një rritje e lehtë e pozicionit krahasuar me periudhën 31 Dhjetor 2016 që është rrjedhë normale e menaxhimit të portfolios, kryesisht i bazuar në normë optimale të kthimit.

8. Plasmanët me bankat jo-vendore

Ne kuadër të këtij grupimi bëjnë pjesë plasmanët në tregun e parasë në bankat jo vendore. Norma e kamatës për këto plasmane deri në tremujorin e parë 2017 mesatarisht është rreth 0.033% (minimum. 0.005% dhe maksimum. 0.10%), ndërsa ne vitin 2016: min. 0.005% dhe maksimum 0.10% me mesatare prej 0.033%). Këto plasmane kryesisht kanë maturitetet të kontraktuar deri në një vit. Analitika sipas bankave është e shpalosur ne tabelën si me poshtë:

Plasmanët sipas bankave:	31 Mars 2017	31 Dhjetor 2016
Raiffeisen Zentralbank	215,026,254.16	195,049,006.93
Gjithsej	215,026,254.16	195,049,006.93

Ashtu sikurse edhe vërehet lehtë nëse krahasojmë 31 dhjetor 2016 dhe 31 mars 2017 mund të shihet se ka rritje të lehtë të pozicionit (përkatesisht zërit) në fjalë në kuadër të grupimit nën shënim 8.

9. Mjetet e ndërlidhura me FMN

	31 Mars 2017	31 Dhjetor 2016
Kuota me FMN	104,618,541.29	105,342,765.72
Depozitat në DST (SDR)	54,945,106.93	56,000,536.92
Kamata akruale	333,289.40	257,417.44
Përdorimi i fondeve të FMN-së (SBA)	201,105,397.50	113,959,893.22
Gjithsej	361,002,335.12	275,560,613.30

Zërat më lartë rrjedhin nga anëtarësimi i Kosovës në FMN. Zëri i parë paraqet vlerën e kuotës së obligueshme (82,600,000 SDR nga shkurt 2016; ndërsa fillimisht ka qenë 59,000,000 SDR) që i është përcaktuar Kosovës nga FMN-ja e shprehur në euro. Ndërsa zëri i dytë paraqet fillimisht vlerën e depozituar në DST në emër të Republikës së Kosovës sipas vendimeve të Bordit të guvernatorëve të FMN-së me 28 Gusht 2009 (43,737,278 SDR) dhe 9 Shtator 2009 (11,631,135 SDR) e ndryshuar për transaksionet – të hyrat dhe shpenzimet e interesit dhe pagesat në emër të rritjes së kuotës po ashtu të shprehura në euro në tabelën më lartë.

Depozitat në DST – Të Drejtat Speciale të Tërheqjes (Special Drawing Rights – SDR) janë depozita që sjellin interes mesatarisht prej 0.31% për periudhën raportuese.

Zëri përdorim i fondeve të FMN-së paraqet mjetet e marra nga FMN-ja sipas marrëveshjeve aktive për shfrytëzim të linjës kreditore (SBA) nga Qeveria e Kosovës. Ndryshimet kryesisht janë rrjedhe e disbursimeve dhe pagesave për të gjitha marrëveshjet aktive dhe pjesërisht nga ndryshimit në kursin e këmbimit EUR/SDR (vlerësimi i SDR-ve kundrejt EURO-s).

10, 11 Mjetet e prekshme dhe të paprekshme

<i>Kategoria e Mjeteve Themelore</i>	<i>Kosto Historike</i>	<i>Zhvlerësimi/ Amortizimi i Akumuluar deri me 31 Dhjetor 2016</i>	<i>Zhvlerësimi/ Amortizimi i akumuluar i vitit deri me 31 Mars 2017</i>	<i>Gjithsej Zhvlerësimi/ Amortizimi i akumuluar 31 Mars 2017</i>	<i>Vlera Neto me 31 Mars 2017</i>
<i>Prona, Ndërtesat dhe Pajisjet</i>	8,580,255.22	3,833,012.00	150,240.88	3,983,253.57	4,597,001.65
Pajisje, zyre dhe tjera	2,087,309.51	1,577,957.31	35,422.44	1,613,379.75	473,929.76
Automjetet	320,149.16	232,674.06	7,239.93	239,913.99	80,235.17
Ndërtesa	2,419,936.02	790,313.72	30,249.21	820,562.93	1,599,373.09
Pajisjet kompjuterike	2,065,635.33	1,232,066.91	77,329.30	1,309,396.90	756,238.43
Investime në proces	1,687,225.20	-	-	-	1,687,225.20
<i>Mjetet e Paprekshme</i>	3,731,527.98	1,445,608.56	90,720.09	1,536,327.83	2,195,200.15
Aplikacionet kompjuterike	3,731,527.98	1,445,608.56	90,720.09	1,536,327.83	2,195,200.15
Aplikacione në proces	-	-	-	-	-
<i>Gjithsej</i>	12,311,783.20	5,278,620.56	240,960.97	5,519,581.40	6,792,201.80

12. Mjetet tjera

Mjetet tjera përbehen si më poshtë:

	31 Mars 2017	31 Dhjetor 2016
Te hyra akruale	1,000,340.63	1,059,096.54
Parapagime	341,940.68	87,543.30
Gjithsej	1,342,281.31	1,146,639.84

13. Detyrimet ndaj bankave në vend

	31 Mars 2017	31 Dhjetor 2016
ProCredit Bank - Kosovë	61,934,796.60	44,918,207.43
Raiffeisen Bank - Kosovë	67,635,255.21	69,643,798.37
NLB Prishtina	43,688,205.05	41,858,837.37
Komercijalna Banka - Dega Mitrovicë	5,256,585.45	5,193,347.27
Banka Ekonomike e Prishtinës	33,703,287.49	36,867,456.44
Banka për Biznes	14,946,718.82	27,247,759.60
Banka Kombëtare Tregtare	24,354,014.21	26,045,562.14
Turk Ekonomi Bankasi Sh.A	34,155,405.44	31,987,685.65
Turkiye Is Bankasi A.S.	14,632,032.62	11,355,178.03
T.C. Zirat Bankasi A.S.Dega Kosove	1,913,055.82	1,105,548.65
Banka Kreditore e Prishtinës	62,426.79	175,538.73
Gjithsej	302,281,783.50	296,398,919.68

Të shpalosura në këtë grup janë saldot e bankave komerciale që operojnë në vend. Bankat komerciale që veprojnë në Kosovë në BQK mbajnë mjetet sipas rregullativës ligjore për rezervën e likuiditetit. Në total shuma e shpalosur më lartë për periudhën raportuese 31 Mars 2017 është rreth 2.32 herë më e lartë se sa shuma e rezervës së obliguar për të mbajtur në BQK.

14. Detyrimet ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN

	31 Mars 2017	31 Dhjetor 2016
Llogaria rrjedhëse FMN Nr. 1	261,546.35	263,356.91
Llogaria shpenzimeve FMN Nr. 2	6,332.84	6,376.68
Llogaria e FMN-së, në përkujdesje	280,048,699.56	193,449,682.23
Pjesa e paguar e Kuotës të FMN-ja	18,302,213.32	18,414,943.37
Alokime nga FMN-ja në formë të DST	70,127,876.53	70,613,338.49
Kamata akruale	341,554.61	261,730.73
Gjithsej	369,088,223.21	283,009,428.41

Zërat më lartë paraqesin pozicionet e llogarive të ndërlidhura me FMN-në që kanë rrjedhur pas anëtarësimit të Kosovës në FMN.

Të tre zërat e parë paraqesin llogari të hapura sipas rregullativës së FMN-së, dy janë llogari operative dhe një është llogari në përkujdesje për letrat me vlerë që Qeveria e Kosovës ka lëshuar si nota të pagueshme ndaj FMN-së.

Pjesa e paguar e kuotës është e mbajtur në SDR (14,160,000 SDR), e cila në tabelë më lartë është e shprehur në euro.

Te Drejtat Speciale të Tërheqjes (DST) në FMN janë alokimet e përmendura në *shënimi 9* sipas alokimeve me 28 Gusht dhe 09 Shtator 2009 (të dy alokimet së bashku janë në vlerë prej 55,368,413 SDR) po ashtu të shprehura në euro në tabelën e shënimit 14.

15. Detyrimet ndaj Institucioneve qeveritare

Detyrimet ndaj institucioneve qeveritare kanë këtë përbërje:

Llogarit rrjedhëse	31 Mars 2017	31 Dhjetor 2016
Thesari – Ministria e Financave	354,931,901.27	257,393,116.03
Agjencia Kosovare për Privatizim	459,156,584.79	460,961,350.11
Institucionet e përkohshme administrative	55,782.73	80,453.69
Gjithsej (llogari rrjedhëse)	814,144,268.79	718,434,919.83

Depozitat në llogari rrjedhëse përfitojnë kamatë prej 0.00% (si për periudhën raportuese, ashtu edhe periudhën krahasuese). Aftazime aktive në periudhën raportuese nuk ka, po ashtu edhe për vitin 2016 përkatësisht me 31 Dhjetor 2016 nuk ka pasur aftazime. Ndryshimi është rrjedhe e aktiviteti operative të institucioneve qe përbejnë grupin.

16. Detyrimet ndaj institucioneve publike dhe komerciale

Detyrimet ndaj institucioneve publike dhe komerciale të paraqitura ne vijim të gjitha janë mjete në llogari rrjedhëse:

	31 Mars 2017	31 Dhjetor 2016
Kompanitë e sigurimeve	4,971,567.95	4,651,685.93
Institucione dhe kompani publike	47,972,001.50	54,213,821.98
Fondet e pensioneve dhe tjera	1,791.83	1,797.83
Gjithsej	52,945,361.28	58,867,305.74

Kemi një zvogëlim të lehtë krahasuar me 2016, qe i atribuohet llogarisë së Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë (FKGK) dhe si dhe llogaria Trusti Pensional i Kursimeve të Kosovës. Duhet edhe këtu të theksojmë se ndryshimi rrjedh nga aktiviteti operativë i institucioneve/llogarive qe përbejnë grupin.

17. Detyrimet nga Huamarrja/et

	31 Mars 2017	31 Dhjetor 2016
Huamarrja nga Banka Botërore	2,266,259.07	2,133,133.87
Gjithsej	2,266,259.07	2,133,133.87

Kemi dy projekte që janë financuar nga Banka Botërore përmes kredisë: projekti për *Planin e vazhdimësisë së punës* dhe projekti për *Sistemin e pagesave në kohë reale (RTGS)*. Projekti për *Sistemin e pagesave në kohë reale* është në funksion nga muaji korrik 2016 ndërsa ai për vazhdimësinë e punës (funksionit) është inaguruar në fund të vitit 2016.

18. Detyrime tjera

	31 Mars 2017	31 Dhjetor 2016
Llogari në përkujdesje	756,036.51	756,036.51
Të hyrat e shtyra	670,274.91	695,741.19
Llogari të pagueshme dhe shpenzime akruale	294,981.26	587,474.42
	-	-
Gjithsej	1,721,292.68	2,039,252.12

Në kuadër të grupit vërehet zvogëlim i lehtë në gjithsej saldon e grupit krahasuar me 31 Dhjetor 2016. Kryesisht i ndikuar nga zvogëlimi i saldës së *llogarive të pagueshme dhe të hyrave të shtyra* me 31 Mars 2017, krahas asaj me 31 Dhjetor 2016.

19, 20 Kapitali autorizuar dhe Rezervat**Kapitali dhe Rezervat e Përgjithshme**

	31 Mars 2017	31 Dhjetor 2016
Kapitali i autorizuar	30,000,000.00	30,000,000.00
Fondi i Rezervave	22,682,588.69	21,022,583.81
Rezultati neto i periudhës	250,371.80	1,660,004.88
Gjithsej	52,932,960.49	52,682,588.69

Rezultati financiar është pozitiv i ndikuar nga tri elemente dominuese:

- i) të hyra më të larta të neto interesit,
- ii) nivel i kënaqshëm për t'hyrat nga tarifat në shërbime dhe aktiviteti rregullator, dhe

21. Neto te hyrat nga kamatat

	31 Mars 2017	31 Mars 2016
Te hyrat nga kamata		
Prej plasmanëve	17,969.45	214,035.27
Prej letrave me vlerë	241,858.75	176,164.80
Prej depozitave në llogari rrjedhëse	47,762.89	7,287.01
Prej normave negative në depozita*	140,027.38	-
	447,618.47	397,487.08
Shpenzimet e kamatave		
Ndaj llogarive rrjedhëse	65,773.45	10,567.95
Ndaj bankave korrespondente	69,491.89	-
Në depozitat e afatizuar	-	-
Nga huazimi/et	5,092.02	1,993.53
	135,265.34	10,568.00
Neto te hyrat nga interesi	312,353.13	386,919.08

Siç mund të vërehet nga Tabela nën shënim 21, të hyrat nga kamatat janë rreth 13% më të larta krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo është një prej faktorëve kryesor që të kemi rezultat pozitiv për përudhën e raportimit. Normat mesatare të kamatës për neto të hyrat nga kamatat (duke marrë në konsiderate vetëm portfolion e angazhuar) sillen në rreth 0.223% (në periudhën e njëjte të vitit 2016 0.170%). Nëse e marrin në konsiderate gjithsej portfolion kemi normën mesatare prej 0.155% të neto kamatës së realizuar.

*Duke ju referuar normave negative që po përcjellin tregjet financiare të valutës euro, bazuar edhe në normat referente të BQE (ECB), BQK ka vendosur norma negative në disa nga depozituesit e saj që nga shtatori 2016.

22. Neto te hyrat nga tarifat dhe ndalesat në shërbime

	31 Mars 2017	31 Mars 2016
Te hyrat nga tarifat dhe ndalesat		
Nga depozitat/tërheqjet në para të gatshme	139,499.43	90,946.74
Nga transferet hyrëse	9,257.00	12,059.71
Nga transferet dalëse	63,585.04	74,484.21
Nga transferet vendore (<i>Sistemi i pagesave vendore</i>)	199,813.32	208,654.37
Nga sistemi i regjistrimit të kreditove	34,263.70	32,532.00
Të hyra nga tarifa tjera	8,148.00	8,929.00
	454,566.49	427,606.03
Shpenzimet nga tarifat dhe ndalesat		
Prej transportit të parasë së gatshme	37,000.00	79,903.37
Nga transaksionet me banka korrespondente	1,802.91	2,786.48
Prej shërbimeve të pagesave përmes SNP	-	13,996.55
	38,802.91	96,686.40
Neto pozicioni nga tarifat dhe ndalesat	415,763.58	330,919.63

Kemi rritje krahasuar me 31 Mars 2016, kjo e rrjedhe nga rritja e volumit të aktiviteti veçanërisht të zëri i parë i grupit.

23. Të hyrat nga aktiviteti rregullator

	31 Mars 2017	31 Mars 2016
Nga mirëmbajtja e licencave të bankave	590,000.00	509,000.00
Nga licencat prej institucioneve bankare	1,000.00	5,900.00
Nga mirëmbajtja e licencave të kompanive të sigurimeve	254,000.00	240,000.00
Nga licencat prej kompanive të sigurimeve	27,950.00	42,550.00
Te hyrat nga aktiviteti rregullator i fondeve pensionale	6,000.00	5,000.00
Nga aktiviteti rregullator i institucioneve tjera financiare (jo bankare)	51,650.00	46,600.00
Gjithsej	930,600.00	849,050.00

Ndryshimi si rritje kryesisht është e mbështetur në rritjen e bazës (volumit të aktivitetit) krahasuar me periudhën e njëjtë 2016.

24. Të hyrat nga grantet

	31 Mars 2017	31 Mars 2016
Të hyrat nga grantet	25,428.47	16,654.83

Tri janë grantet që aktualisht efektojnë zërin në shënim 24. Ato janë granti për sistemin e menaxhimit të tërë procesit të *emetimeve të letrave me vlerë të qeverisë* (faktikisht i tërë sistemi është dhënë si grant, pastaj financimi pjesërisht në formë të grantit për sistemin e *regjistrimit të kreditëve*, si dhe granti për *sistemin e mbikëqyrjes financiare*. Efekti në të hyra nga këto tri grante është i shpalosur në kuadër të këtij shënimi.

25. Të hyrat tjera operative

	31 Mars 2017	31 Mars 2016
Të hyra tjera	-	1,969.40

Të hyra nga aktivitete jo të zakonshme të BQK-se dhe te cilat nuk kanë mundur të klasifikohen në zërat specifik të të hyrave.

26. Shpenzimet e personelit

	31 Mars 2017	31 Mars 2016
Shpenzimet e pagave dhe kompensimeve	780,691.20	666,500.24
Shpenzimet e kontributeve dhe sigurimi shëndetësor	170,142.81	154,430.25
Shpenzimet e trajnimeve	8,505.01	10,052.20
Shpenzimet për Bordin e BQK-së	19,524.27	22,143.53
Shujta ditore	32,979.00	33,196.50
Shpenzime tjera	6,710.11	6,701.38
Gjithsej	1,018,552.40	893,024.10

Gjithsej numri i punëtorëve që kanë qenë aktivë në listën e pagave gjatë periudhës janar-mars 2017 është: 215 (215 në janar - mars 2016). Në kategorinë *tjera te shpenzimet e personelit* përfshihet *kompensimi shtesë pensional (2017, 3,598.89 euro; 2016, 3,598.89 euro), pagesat për programin e praktikës për student (2017, 160.00 euro; 2016, 40.00 euro) dhe mbështetja financiare për strehim (2017, 2,951.22 euro; 2016, 3,062.49 euro).*

Kompensimi shtesë pensional është rrjedhojë e vendimeve të mëhershme, nga ku disa ish punëtor kompensohen drejtpërdrejt nga BQK-ja, në pamundësi për bartjen e këtij detyrimit ndaj tyre të fondet pensionale në momentin kur BQK-ja ka bartur menaxhimin e fondit shtesë pensional.

27. Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative

	31 Mars 2017	31 Mars 2016
Shpenzimet e sigurimit	48,030.52	45,267.25
Riparime dhe mirëmbajtje	7,741.35	8,503.71
Mirëmbajtje të aplikacioneve	60,974.67	70,155.56
Shpenzime komunikimi (telefoni, fax-i dhe interneti)	4,605.62	2,960.80
Shpenzimet e shërbimeve publike/komunale	31,608.70	19,423.55
Shpenzimet e konsultimeve dhe të auditimit	1,628.40	-
Shpenzime të sigurimit fizik (të objektit dhe të transportit)	5,580.00	5,580.00
Udhëtimet dhe transporti	25,262.49	19,349.38
Shpenzimet operative të automjeteve	2,106.74	3,244.50
Material shpenzues administrativ	1,263.13	5,274.04
Shpenzimet e bufesë (për kafe ndaj personelit dhe takime të ndryshme)	7,463.19	7,288.22
Shpenzime për furnizime (për pajisje të TI dhe jo TI)	2,512.69	1,377.77
Publikimet dhe literatura	2,492.40	3,097.18
Shpenzime të përfaqësimit	9,116.50	5,251.90
Tarifa anëtarësimi në institucione profesionale	9,870.55	2,455.30
Tjera	8,103.86	12,797.14
Gjithsej	228,360.81	212,026.30

Ndryshimi kryesisht është rrjedhe e funksionalizimit të *Qendrës për vazhdimësi të punës* në Prizren dhe ndonjë aktivitet që nuk ka pasur periodicitet të njëjtë në periudhat krahasuese.

28. Neto rezultati nga ndryshimet e kursit të këmbimit

	31 Mars 2017	31 Mars 2016
Neto fitimi/humbja e perealizuar nga kursi i këmbimit	52,300.67	984,790.36

Rezultati i paraqitur më lartë është i përkohshëm (specifikisht vetëm për datën e raportimit) dhe mund të lëvizë varësisht nga lëvizja e kursit të këmbimit EUR/SDR.

29. Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj

Shënim		31 Mars 2017	31 Dhjetor 2016
Paraja e gatshme	5	210,082,152.81	154,800,143.92
Llogaritë rrjedhëse me bankat jo rezidente	6	212,635,429.95	207,742,023.04
Letra më vlerë me maturitet deri në tre muaj		9,059,775.53	9,405,964.75
Llogaritë depozituese me bankat jo rezidente dhe me maturitet deri në tre muaj		-	-
Gjithsej		431,777,358.29	371,948,131.71

30. Detyrimet e pritura dhe kontingjente**Anëtarësimi ne Bankën Botërore**

Pas anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Bankën Botërore dhe nënagjencionet e saj Qeveria e Kosovës ka lëshuar nota të pagueshme (sipas kërkesës) duke u zotuar se do të paguaj sipas kërkesës së Bankës Botërore (nënaagjencioneve të saj) për pjesën e tarifës së anëtarësisë. Vlera e tyre me 31 Mars 2017 është rreth 645,152 euro (me 31 Dhjetor 2016 ky detyrim i pritshëm ka qenë 645,152 euro), BQK luan rolin e ndërmjetësit financiar (bankës garantuese) dhe mjetet mbahen në llogari nën-përkujdesje (garantuese).